

URDHËR
Nr. 123, datë 15.4.2025

**PËR DELEGIMIN E KRYERJES SË DETYRAVE QË KANË TË BËJNË ME
PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 26, dhe germës “i”, të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të udhëzimit nr. 4, datë 18.6.2021, “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, si dhe të udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021, “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kancelarit, z.Donald Xhelili, për kryerjen e detyrave dhe nënshkrimin e akteve për të gjitha procedurat e prokurimit pranë kësaj gjykate.
2. Organi i deleguar nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.
3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.
4. Ngarkohet kancelari, z.Donald Xhelili, për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi në datë 15.4.2025 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Gerd Hoxha